



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN ОТВОРЕНО
SOCIETY ОПШТЕСТВО
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА

STRATEGJIA E FONDACIONIT SHOQËRIA E HAPUR MAQEDONI 2014-2017

Fondacioni Shoqëria e hapur - Maqedoni (FShHM), në periudhën 2014-2017 do t'i orientojë resurset dhe përpjekjet e saj drejt përbushjes së synimit afatgjatë për **kthimin e demokracisë dhe qeverisjes demokratike**. Kjo do të arrihet përmes (1) mbështetjes së 12 organizatave qytetare për avancim në fushat e cekura: **liria e shprehjes, angazhimi rinor për ndryshime sociale, avancimi i të drejtave të njeriut në shëndetësi, monitorimi dhe dokumentimi për të drejtat e njeriut, lufta kundër korrupsionit, transparenca buxhetore**, si dhe (2) përmes zbatimit të tre koncepteve të ndryshme, në kuadër të strategjisë: **Përforcimi dhe mobilizimi i qytetarëve, Komuna sipas nevojës së qytetarëve, Integrimi i romëve**.

FShHM do t'i mbështesë dhe do të bashkëpunojë me organizatat kyçe në çdonjërin prej **gjashhtë fushave**, të identifikuar si fusha me të rrezikuara dhe njëkohësisht dhe më të rëndësishme për kthimin e demokracisë dhe qeverisjes demokratike. Organizatat e përzgjedhura kanë ekspertizë relevante, qasje ndaj grupeve në shënjestër, koalicione të formuara mirë, si dhe bazë të studentëve të mëparshëm (alumni), që ua mundëson formimin e strategjive të tyre, si dhe u mundëson të përgjigjen ndaj kërcënimeve të mundshme dhe rrethanave.

Qëllim i konceptit të FShHM-së për **përforcimin dhe mobilizimin e qytetarëve** është të kontribuon në ngjalljen e qeverisjes demokratike. Individët, grupet joformale dhe organizatat e përforcuara qytetare, të koordinuara në një platformë të hapur, përfshirëse dhe jopartiake, do t'i aktualizojnë çështjet akute dhe provokuese si përgjigje ndaj përkeqësimit të demokracisë. Ligjet dhe politikat alternative, të zhvilluara përmes pjesëmarrjes do t'i demonstrojnë përfitimet e përfshirjes qytetare dhe do t'i mobilizojnë aktorët e shoqërisë qytetare për ndërmarrjen e veprimeve dhe veprimit të shtuar për çështjet e interesit publik.

Koncepti **Komuna sipas nevojës së qytetarëve** e synon rritjen e kapaciteteve administrative dhe financiare të vetëqeverisjes lokale, qeverisjes së mirë në shkolla, si dhe përforcimin e sektorit qytetar për pjesëmarrje aktive në jetën e bashkësisë. Përkrahja do ta mundësojë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e krijimit të politikave në nivel lokal, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të komunës.

Mbajtja e **integritit të romëve** në nivel të lartë në listat e prioriteteve të agjendës nacionale edhe pas vitit 2015 dhe përshpejtimi i përmbushjes së qëllimeve të parapara me Strategjinë nacionale për integrimin e romëve janë prioritetet kryesore të konceptit të tretë. Në procesin e përmbushjes së qëllimit për zvogëlimin e dallimit mes aspekteve politike dhe atyre poraktike që lidhen me romët, si parakusht për integrimin e tyre, përpjekjet e FShHM-së do të orientohen drejt përforcimit të romëve për realizimin e të drejtave të tyre shëndetësore dhe avancimin e rezultateve në arsim, si dhe drejt kërkimit të llogaridhënies nga Qeveria gjatë realizimit të shërbimeve shëndetësore dhe arsimore.

PËRKRAHJA E FUSHAVE NË VITIN 2014

Liria e shprehjes - Katër portale (*plusinfo.mk, portalb.mk, a1on.mk dhe okno.mk*) do të mbështeten me qëllim të sigurohet qasje ndaj informatave të sakta dhe paanshme, për të dhënë pluralizëm dhe infrastrukturë të nevojshme për shprehje të lirë. *Fondacioni Metamorfozis* do të fitojë përkrahje për mirëmbajtjen e hapësirave ekzistuese dhe krijimin e hapësirave të reja në internet për përforcimin e zërave alternativë dhe burimeve të lajmeve dhe mendimeve, ndërsa *Qendra për zhvillimin e mediave* do të sigurojë ndihmë juridike falas për mediat dhe gazetarët, si dhe do t'i shfrytëzojë partneritetet ndërkombëtare për përfaqësim kundër kufizimit të mëtejshëm të lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave.

Angazhimi rinor për ndryshime shoqërore - FShHM do ta mbështesë partnerin e saj besnik disavjeçarë, *Forum in rinor arsimor*, në krijimin dhe realizimin e procesit të përforcimit të angazhimit rinor. Në këtë mënyrë, do të avancohet kjo organizatë, si dhe mbarë aktivizmi rinor. Do të sigurohet mbështetje për aktivitetet në 12 qendra rinore në mbarë vendin, për krijimin e pluralizmit në organizimin e shkollave të mesme dhe atë studentor, mbështetje e Radio MOF-it, si dhe për aktivitetet e Këshillit nacional rinor.

Avancimi i të drejtave të njeriut në shëndetësi - *HOPS - Opsione për jetë të shëndoshë Shkup* do të fitojë mbështetje me qëllim që të sigurohet ndihmë juridike falas për punëtorët seksualë dhe shfrytëzuesit e drogave, të përfaqësohen të drejtat e personave të mitur të cilët e shfrytëzojnë drogën, për mbikëqyrjen dhe përfaqësimin e financimit shtetëror të programeve për zvogëlimin e dëmeve. *Koalicioni "Të drejtat seksuale të bashkësive të marginalizuara"* do të mbështetet për monitorimin dhe dokumentimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në shëndetësi, shërbime juridike për personat transgjiorë, përfaqësimin për përmirësimin e Ligjit për të drejtat e pacientëve, debatet publike për çështjet e seksualitetit në arsim, etj.

Mbikëqyrja dhe dokumentimi për të drejtat e njeriut - *Komiteti i Helsinkit i Republikës së Maqedonisë për të drejtat e njeriut*, si një prej organizatave që njihen më së shumti për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, do të merr përkrahje për hartimin e raporteve për gjendjen e të drejtave të njeriut, ndihmë juridike për 300 persona, monitorimin e 30 rasteve gjyqësore, hartimin e raporteve të rregullta dhe ngritjen e vetëdijes për të drejtat e njeriut.

Lufta kundër korrupsionit - Mbështetja për *Qendrën maqedonase për edukim evropian* do të sigurojë qasje në shkallën e pranimit të vlerave evropiane në shoqërinë maqedonase, transparencën e programimit dhe shfrytëzimit të fondeve të BE-së, avancimin e vendit në integrimin në BE, si dhe do të sigurojë trajnim për 80 përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe mediave për Bashkimin Evropian.

Transparenca buxhetore - *Asociacioni për emancipim, solidaritet dhe barazi të femrave në Maqedoni - ESE* do të merr përkrahje për monitorimin e programeve qeveritare për mbrojtje preventive shëndetësore, si dhe për monitorimin e buxhetit të Fondit për sigurim shëndetësor, përkrahje teknike për monitorimin e këshilltarëve para-juridikë në OJQ-të rome, trajnime për hartim buxheti dhe monitorim në bashkësi, si dhe për përgatitjen e kornizës juridike për qasjen ku kombinohet përforcimi juridik dhe llogaridhënia sociale.

KONCEPTET NË VITIN 2014

Në drejtim të përforcimit të përgjigjeve qytetare ndaj praktikave me të cilat përkeqësohet demokracia, koncepti i FShHM-së për **përforcimin dhe mobilizimin e qytetarëve**: do t'i rrisë kapacitetet e 300 individëve, grupeve joformale dhe organizatave qytetare përmes realizimit të trajnimeve për nxënien e aftësive (qasje e lirë ndaj informatave me karakter publik, aktivizëm në internet dhe rrugë, strategjive për marrëdhënie publike dhe zbulim të propagandës) do t'i konsolidojë aktorët e shoqërisë qytetare në një platformë të hapur, jopartiake dhe joelitiste për veprim qytetar, të bazuar në vlerat e përbashkëta për shoqëri të hapur dhe solidaritet; do të sigurojë grante për individët të cilët janë aktivë në mediat sociale dhe bazat lokale të aktivistëve; do të sigurojë informim dhe motivim të qytetarëve përmes alarmeve në gjuhë të ndryshme, duke i shpallur konstatimet e monitorimit të rregullt të politikave dhe ligjeve, do të vazhdojë me sigurimin e hapësirës dhe pajisjes për aktivitetet e organizatave qytetare dhe nismave të ndryshme qytetare në Klubin GEM në çarshinë e vjetër të Shkupit, ndërsa pasditet e të shtunave do të rezervohen për debate publike të organizuara nga FShHM.

Do të formohen grupe pune, të përbëra nga përfaqësues të organizatave qytetare, aktivistë, ekspertë dhe deputetë, për revidimin e dy ligjeve dhe zhvillimin e ligjeve dhe politikave alternative, të cilat do të shërbejnë si modele të politikave dhe qeverisjes demokratike.

FShHM do të vazhdojë me realizimin e Projektit të USAID-it për shoqëri qytetare, deri në fund të gushtit 2014, duke siguruar mbështetje për përforcimin e kapaciteteve dhe realizimin e granteve për organizatat qytetare, të cilat veprojnë si baza demokratike, ushtrojnë vëzhgim mbi pushtetin dhe realizojnë aksione të përbashkëta. Do të vazhdon edhe bashkëpunimi me Universitetin zviceran të Friburgut në kuadër të Programit regional për mbështetje të hulumtimeve për të siguruar ndihmë teknike për institucionet për realizimin e granteve hulumtuese në shkencat shoqërore.

Aktivitetet në kuadër të konceptit **Komuna sipas nevojës së qytetarëve** do të realizohen në 3 komuna më të mëdha urbane dhe multietnike, të cilat kanë shprehur gatishmëri dhe përkushtim për bashkëpunim me FShHM-në, me qëllim që të arrihet ndryshimi institucional dhe përforcimi i demokracisë lokale.

Trajnimet e dedikuara për përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale, sektorit qytetar dhe shkollave pritet të rezultojë me pjesëmarrje të shtuar të këtyre aktorëve në procesin e krijimit të politikave dhe implementimit të tyre në nivel lokal. 240 përfaqësues të vetëqeverisjes lokale do të trajnohen për planifikim strategjik, krijim të politikave përmes pjesëmarrjes, shfrytëzim të fondeve të BE-së dhe krijim të strategjive për komunikim; 180 përfaqësues të sektorit qytetar do të fitojnë dituri për kuptim më të mirë të kompetencave komunale, politikave për anti-diskriminim dhe fondeve të BE-së, ndërsa 180 pjesëmarrës nga shkollat do të trajnohen për menaxhim demokratik, drejtësi sociale dhe krijim të planeve shkollore zhvillimore. Për të gjitha tre komunat do të sigurohet ndihmë teknike për hartimin e draft-politikave për arsim, të rinjtë, mbrojtje sociale dhe bashkëpunim me sektorin qytetar. Do të organizohen edhe debate publike, me qëllim që të sigurohen debate të hapura për draft-politikat e përgatitura, ku dokumentet e shqyrtuar do t'i dërgohen këshillave komunalë për miratim.

Do të sigurohet mbështetje financiare për hapjen e nga një qendre të bashkësisë në çdonjërin prej tre komunave. Përmes qendrave të cekura, përmes së cilave do të sigurohet ndihmë juridike dhe administrative për qytetarët, si dhe edukim joformal për të rinjtë dhe të rriturit. Qendrat do të shfrytëzohen edhe si hapësira për realizimin e aktiviteteve të klubeve rinore dhe nismave tjera kulturore dhe qytetare me karakter lokal.

Programi *Forumet në bashkësi*, që realizohet në bashkëpunim me Agjencinë zvicerane për bashkëpunim dhe zhvillim, do ta mobilizojë pjesëmarrjen qytetare në identifikimin e prioriteteve për zhvillimin e bashkësisë lokale, si dhe do t'i përzgjedhë projektet relevante për financim në komunat në shënjestër.

Projekti *Qasje ndaj drejtësisë në Maqedoni* i finansuar nga Instrumenti evropian për dekomraci dhe të drejta të njeriut synon mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përmes përforcimit të sistemit për ndihmë juridike falas.

Koncepti për **integrimin e romëve** fokusohet tek pabarazia me të cilën ballafaqohen romët në fushën e shëndetësisë dhe arsimit. Përforcimi i romëve në realizimin e të drejtave shëndetësore do të realizohet në bashkëpunim me Programin për shëndetësi publike të FShH-së, duke i kombinuar qasjet dhe veglat e ndryshme, gjegjësisht: sigurimin e ndihmës juridike dhe para-juridike për 8 bashkësi romë; përcjelljen e vazhdueshme të cilësisë së shërbimeve të realizuara në fushën e imunizimit dhe kujdesit antenatal; trajnimin për shfrytëzimin e avancuar të veglave të mediave për ndryshimin e prezantimit negativ të romëve; përkrahjen e vazhdueshme teknike dhe organizimin e ngjarjeve për këmbimin e

përvojave, si dhe përmes qasjes së kombinuar ku lidhen konceptet e llogaridhënies sociale dhe përforcimit juridik.

Për ta arritur përforcimin e romëve për avancimin e të arriturave në arsim, përmes Programit arsimor të romëve (të mbështetur nga USAID), Fondacionit për fëmijë Pestaloci dhe Fondit arsimor rom, do të arrihet rritja e nivelit të nxënësve të cilët e përfundojnë arsimin fillor, si dhe do të rritet numri i studentëve të diplomuar romë. Kjo do të arrihet përmes sigurimit të ndihmës së drejtpërdrejtë për 800 nxënës të shkollave fillore, 130 bursave për studentët e fushave të ndryshme akademike (përfshirë edhe mjekësinë), si dhe përmes mbështetjes plotësuese akademike për 170 studentë që do të sigurohet përmes Romaveritas.

Vlerësimi i jashtëm dhe dokumentet tjera, si dhe analizat e lidhura me politikat në fushën e arsimit dhe shëndetësisë do të shfrytëzohen për përfaqësim, si dhe për të kërkuar llogaridhënie dhe përgjegjësi nga Qeveria në krijimin, hartimin e buxheteve dhe realizimin efektiv dhe të drejtë të shërbimeve shëndetësore dhe arsimore. Do të përcjellët avancimi në aspekt të implementimit të Strategjisë së re nacionale për përfshirjen e romëve, si dhe do të ushtrohet presion i vazhdueshëm për transparencë më të madhe, shpërndarje të resurseve dhe llogaridhënie të institucioneve kompetente në arsim dhe shëndetësi.